



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me karakter Profesional “Aplikime
Informatike”
i
Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti European i
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc Olimpjon Shurdi

2. Prof. Asoc Elson Agastra

Tetor 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Për programin e studimit me karakter profesional në “Aplikime Informatike”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Programi me karakter profesional në “Aplikime Informatike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 540 datë 10.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Nuk ka, akreditim për herë të parë
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit (2020-2021):	16 PAE/ 3 PAK
18	Numri i studentëve (3 vitet e fundit):	(9+51+11)= 71
19	Komente / të tjera:	

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Europian i Tiranës është një institucion privat i arsimit të lartë i krijuar në bazë të vendimit Nr. 636, datë 20.09.2006, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 529 datë 04.09.2018, në këtë institucion është hapur njësi kryesore “Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës”.

Programi i studimit me karakter profesional në “Aplikime Informatike” zhvillohet pranë njësisë bazë “Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë”, pjesë e njësisë kryesore “Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës”.

Në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë në fuqi, programi i studimit me karakter profesional në “Aplikime Informatike” është hapur bazuar në Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 540, datë 10.09.2018 me kohëzgjatje normale akademike dy vite, 120 Kredite ECTS.

Ky vlerësim është në kuadër të akreditimit të parë të këtij programi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit me karakter profesional në "Aplikime Informatike".

Bazuar në Urdhërin nr. 31, datë 05.05.2021, "Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti European i Tiranës", grupi i vlerësimit përbëhet nga:

1. Prof. Asoc. Olimpjon Shurdi

2. Prof. Asoc. Elson Agastra

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, znj. Aviola Bardhi.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Maj 2021 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti European i Tiranës (UET) për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti European i Tiranës, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë".

Gjatë vizitës së kryer në UET, në datën 15 Qershor 2021, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit European të Tiranës. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit të procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterave, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave.

Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Më datë 16.09.2021, përmes sistemit AMS, Universiteti European i Tiranës (UET) është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi dhe me shkresë zyrtare Nr. Prot, 19/67, datë 16.09.2021. Më datë 28.09.2021, UET përcjell në sistemin AMS shkresën me Nr. Prot, 78/54, datë 28.09.2021 me të cilën shpreh dakordësinë me përmbajtjen e draftit.

Sa më sipër, Draft- Raporti kthehet në Raport përfundimtar.

Vlerësimi i programit të studimit me karakter profesional “Aplikime Informatike”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Referuar dokumentacionit të Dosjes së Vetëvlerësimit (për më tej DVV) rezulton se programi i studimit profesional “Aplikime Informatike” është licensuar me Urdhër Nr.540, datë 10.09.2018 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, dhe për herë të parë është aktivizuar në vitin akademik 2018-2019. Programi i studimit profesional “Aplikime Informatike” është hartuar në linjë me qëllimet dhe misionin e Universiteti Europian i Tiranës (UET). Referuar statutit dhe strategjisë së zhvillimit, misioni i UET orientohet drejt krijimit, zhvillimit e transmetimit të dijeve, në pajisjen me aftësi dhe kompetenca të studentëve, të nevojshme këto, për të qënë profesionistë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe aplikimeve informatike. [Dok 2,3,4. Statuti i UET; Plani Strategjik UET 2015-2020; Plani strategjik për zhvillimin e planit të studimit]
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Referuar strategjisë së UET, në dokumentacionin e DVV, por edhe nga takimi me drejtuesit e njësive bazë dhe stafin e saj, konstatohet se është e mirëpërcaktuar oferta dhe drejtimit akademike, të orientuara drejt shkencave aplikative inxhinierike (inxhinieri telekomunikacioni, informatike ekonomike), në inxhinieri industriale (inxhinieri elektrike, mekanike), shkenca ekonomike dhe menaxheriale (finance, administrim, informatike ekonomike), shkenca mjeksore etj. Universiteti ka të shprehur qartë në të gjithë dokumentet strategjike qëllimet dhe objektivat specifike, të cilët mbështesin programet e studimit si në kuadër të interesave kombëtare, sikurse edhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. [Dok 2,3,3,4,5 Statuti i UET; Plani Strategjik UET 2015-2020; Plani strategjik për zhvillimin e planit të studimit; Rregullore e UET].
Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësive kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësive bazë përgjegjëse për programin e	Bazuar dokumentacionit për programin profesional “Aplikime Informatike”, konstatohet se në tërësinë e tij përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me aktet rregullatore të institucionit, prioritetet e zhvillimit strategjik të institucionit Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës dhe për më tepër ato janë në të njëjtën linjë në zbatim të strategjisë së UET dhe

studimit.	të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës në veçanti. [dok. 4 Plan strategjik për zhvillimin e planit të studimit].			
Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Nga shqyrtimi i DVV, rezulton se UET realizon në mënyrë të përvitshme studime të tregut të punës për shumë fusha në vend. Edhe para hapjes së programit të studimit ka një studim të tregut lokal të punës. Ekziston një njësi e quajtur Bordi i Tregut të Punës i cili së bashku me drejtuesin e Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë (DIT) analizojnë kërkesat dhe nevojat e përpunimit të programit të studimit. [dok. 16, 17; Studimi i tregut të punës përpara hapjes së programit; Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve].			
Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.	Bazuar në institucioni dëshmon se realizon studime periodike të tregut të punës gjithashtu ka ngritur zyrën e shërbimit të karrierës e cila dëshmon mbajtjen e lidhjeve me student të diplomuar. [dok.17 Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve], [dok 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj]			
Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Studime paraprake të tregut të punës janë realizuar kryesisht duke u mbështetur në informacione të mbledhura dhe përpunuara nga INSTAT, nuk ka dëshmi të komunikimit me punëdhënësit të fushës përkatëse. Megjithatë tregu i punës për këtë program studimi është në rritje dhe mjaft i kërkuar, duhet bërë më shumë për lidhje dhe orjentim më të mirë të studentëve drejt kompanive të interesuara [konstatim nga komunikimi me studentet].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së	Referuar Statutit të UET, neni 20, në dokumentacionin e DVV, ka një përcaktim dhe ndarje të detyrave dhe kompetencave. Brenda Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës si dhe vetë departamenteve pjesë të këtij fakultetit ka një bashkëpunim ndërveprues i cili dëshmohet në mbulimin e lëndëve të programit të studimit nga pedagog të departamenteve të tjerë. Gjatë takimit të zhvilluar me pedagogët e departamentit DIT, GVJ u informua nga pedagogët në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet pedagogëve

tyre.	brenda fakultetit si dhe studentëve në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. [Dok 2 Statuti i UET]			
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjate e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Bazuar në DVV, dok. 34[1-12], listë e marrëveshjeve të bashkëpunimit UET.pdf, UET dëshmon se ka realizuar një sërë marrëveshjesh afatgjate me qëllim bashkëpunimin në kuadër të praktikave mësimore dhe profesionale në përmbushje të programit të studimit. UET realizon në mënyrë të përvitshme analizë të thelluar mbi objektivat dhe përfitimet e këtyre marrëveshjeve, [Dok .35 Raporti i fundit analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf].			
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Siç e përmendëm në kriterin e mësipërm, UET realizon raporte të përvitshme për të analizuar përfitimet nga këto marrëveshje. Në vitin e fundit akademik 2019-2020 ishin realizuar disa takime me kompani të fushës së IT-se, ishin zhvilluar seminare të përbashkëta si dhe u dhene mundësi studentëve që krijojnë kontakte me kompanitë në të ardhmen me qëllim punësimin e tyre, [Dok .35 Raporti i fundit analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf].			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Departamenti DIT, si njësia përgjegjëse për programin e studimit, në varësi të nevojave të programit të studimit ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, gjithashtu janë lidhur marrëveshje me kompani të fushës së IT-së me qëllim të realizimit të praktikës profesionale dhe punësimin e studentëve. Njësia përgjegjëse DIT ka identifikuar institucionet dhe kompanitë e mundshme për bashkëpunim dhe ka bashkërenduar punën me "Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve" (ZKS) me qëllim të fuqëzimit të bashkëpunimeve. [Dok . 34[1-12] Memorandum bashkëpunimi_UET dhe WE WEB Nr. 123 Prot. Date, 08.05.2017.pdf. etj]			
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativë specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimin të studentëve.	Bazuar në dok në dosjen DVV, institucioni UET për shkak të pandemisë nuk ka mundur të realizojë ndonjë iniciativë konkrete me qëllim mbështetjen e sipërmarrjes dhe punësimin e studentëve, institucioni është mjaftuar vetëm në realizimin e disa leksioneve të hapura. Nga takimi me studentët GVJ konstatohet se nuk kishte asnjë kontakt nga ana e DIT dhe zyrës së ZKS me studentët me qëllim orjentimin e tyre drejt kompanive ku do të realizonin praktikën, studentët ishin të painformuar në lidhje me këtë pikë. [Dok .35 Kalendar i aktiviteteve.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi L3

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit me karakter profesional 2 vjeçar, "Aplikime Informatike" është organizuar në lëndë të shprehura në kredite (ECTS) dhe orë, me një total prej 60 kreditesh në një vit akademik dhe me kohëzgjatje 2 vjeçare (total 120 ECTS). Plani mësimor i vënë në dispozicion shpreh qartë mënyrën e organizimit në vite dhe semestra, me lëndët përkatëse, kreditet/lëndë, ngarkesën mësimore (sipas formave të mësimdhënies) në auditor dhe jashtë auditorit etj. Në DVV është paraqitur dhe grupimi i lëndëve sipas kategorive, shprehur në kredite dhe % si më poshtë: - Lëndë të formimit të përgjithshëm (A) – 20 ECTS (16.6%), - Lëndë karakterizuese profesionale (B) – 59 ECTS (49.2%), - Lëndëve bashkëvepruese /integruese të fushës (C) – 18 ECTS (15 %), - Lëndë të aftësimit informatik dhe praktikës profesionale (D) – 18 ECTS (15 %) - Provim formimi/projekt profesional (E) – 5 ECTS (4.2 %). Programi studimit me karakter profesional 2 vjeçar, "Aplikime Informatike" është në përputhje me nivelin 5 të Kornizës Kombëtare Shqiptare. [Dok.33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf]
Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfitim të njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Nga shqyrtimi i Dosjes së Vetëvlerësimit, GVJ konstaton se programi i studimit me karakter profesional në Aplikime Informatike synon përfitim të njohurive të specializuara teorike dhe praktike në sistemet e informacionit dhe aplikimet informatike. [Dok.33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Dok 19 etj. Syllabuset e lendeve.]
Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.	Programi i studimit DP Aplikime Informatike synon në paisjen e studentëve me aftësi teorike-praktike në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të aplikimeve informatike kryesisht software. GVJ konstaton se duke analizuar planin mësimor dhe syllabuset e lendeve, nuk ka një ndarje të qartë të krediteve kundrejt ushtrimeve dhe laboratoreve, kjo mungon në planin mësimor dhe në syllabuse, është e paqartë zhvillimi i laboratoreve apo i praktikave profesionale brenda lëndës apo moduleve. GVJ mendon se një ndarje në planin mësimor në kredite të laboratoreve/ushtimeve do të përmiresonte raportin teorik-praktik të zhvillimit të programit të studimit dhe do të orjentonte më mirë studentët drejt aspektit praktik. [Dok. 33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Dok 19 etj. Syllabuset e lendeve.]
Kriteri 4. Programet e studimit me	Programi i studimit DP Aplikime Informatike synon të ndihmojë në

karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.	zhvillimin e kompetencave në fushën e IT-së, aplikimeve software, mirëmbajtjes së sisteme dhe rrjetave, hartimin dhe mirëmbajtjen e faqeve web, gjithashtu ato kanë synime në zhvillimin e kompetencave menaxhuese. [Dok. 33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Dok 19 etj. Sylabuset e lendeve.]												
Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.	Universiteti European i Tiranës UET, është institucion i akredituar më Vendim Nr. 46, datë 05.07.2019 të Bordit të Akreditimit. Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës i UET, është njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit DP Aplikime Informatike, përbëhet nga 3 departamente të cilët përmbushin kriteret ligjore për njësitë bazë. Programi i studimit “Aplikime Informatike” ofrohet nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë i Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës të UET-se. Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë ka të punësuar 8 pedagogë më kohë të plotë nga të cilët 1 të kategorisë Prof, 3 Dr, dhe 4 Msc, duke plotësuar kërkesat, kriteret ligjore dhe standartet për të ofruar programin e studimit. Gjithashtu, pjesë e Departamentit janë edhe stafi akademik me kohë të pjesshme dhe stafi i ftuar. Kualifikimi i personelit akademik PAE dhe PAK është në përputhje me nenin 59, pika 6 të Ligjit 80/2015, i cili kërkon minimumi të kenë diplomën Master Profesional. Mbështetur në LAL 80/2015, neni 42, pika 3, drejtuesi e njësisë kryesore është personel akademik i kategorisë “Profesor”. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, për tre vitet e fundit akademike paraqitet në tabelën më poshtë: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>PAE/PAK</th><th>% PAE / % PAK</th></tr><tr><td>2018-2019</td><td>9/3</td><td>75 % / 25 %</td></tr><tr><td>2019-2020</td><td>14/1</td><td>93 % / 7 %</td></tr><tr><td>2020-2021</td><td>16/3</td><td>84 % / 16 %</td></tr></table> [Dok.159 Te dhena Tabelore per stafin mesimdhene per programin e studimit (Aneks Tabelat 6_7_8_12).pdf]	Viti akademik	PAE/PAK	% PAE / % PAK	2018-2019	9/3	75 % / 25 %	2019-2020	14/1	93 % / 7 %	2020-2021	16/3	84 % / 16 %
Viti akademik	PAE/PAK	% PAE / % PAK											
2018-2019	9/3	75 % / 25 %											
2019-2020	14/1	93 % / 7 %											
2020-2021	16/3	84 % / 16 %											
Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	Programi i studimit DP Aplikime Informatike në terësi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve, objektivat mund të orientojnë edhe me mirë studentët drejt fushave të punësimit dhe ti ndihmojnë ato drejt kompanive apo institucioneve me qëllim punësimin e studentëve. Njohuritë që fitojnë studentët duhet të orientojnë drejt aspektit praktik në mënyrë që kjo kategori studentësh në përfundim të programit të studimit ta gjejë veten në tregun e punës. <i>GVJ mendon se një analizë me konkrete e objektiva të programit në tërësi si dhe sylabuseve në vecanti, do ti jepte më tepër garanci në</i>												

	<i>suksesin e një programi të tillë.</i> [Dok. 33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Dok 19 etj. Sylabuset e lendeve.]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënës, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	Referuar DVV dhe takimeve me stafin dhe studentët, GVJ konstaton se Programi i studimit DP "Aplikime Informatike", përmban dhe jep informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën, kriteret e pranimit, procedurat e transferimit dhe mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve. Në programin e studimit, planin strategjik të zhvillimit të tij jepet informacion specifik e i detajuar për objektivat formues të programit, si dhe objektivat formues për çdo lëndë, grupimin e disiplinave sipas veprimtarive formuese, format e mësidhënies, detyrimet për lëndën, mënyrat e vlerësimit të njohurive të lëndës, rezultatet e të nxënës etj. [Dok. 8 Plani Strategjik për zhvillimin e programit.pdf; 33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Dok 19 etj. Syllabusët e lendeve.]
Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.	Programi i studimit me karakter profesional "Aplikime Informatike" është i organizuar në lëndë dhe aktivitete formuese, leksione seminare dhe kontrolli i vazhdueshëm/praktike profesionale, të vlerësuara me kredite dhe të ndara në dy vite akademike. Ndajra në kredite, raporti midis leksione seminare me pjesën praktike nuk është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe përcaktimet evropiane. Në planin mësimor ka lëndë karakterizuese të cilat nuk kanë të parashikuara kredite për laborator apo kontrolli i vazhdueshëm/praktike profesionale si: Programin I dhe II, Algoritëm dhe hyrje në programim. [Dok.33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Dok 19 etj. Syllabusët e lendeve.]
Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.	Referuar DVV, dok 32-33, konstatohet se plani mësimor, një ndër dokumentet kryesore të programit, shpreh qartë organizimin sipas viteve akademike të lëndëve të planifikuara. Cdo vit akademik është i ndarë në 2 semestra. Në plan mësimor ka informacion të plotë lidhur me lëndët për çdo semestër, ngarkesën mësimore në auditor sipas formave të mësimdhënies, ngarkesën në kredite për secilën veprimtari/disiplinë etj. Në përputhje me VKM nr.41/2018 plani mësimor ndjek llogjikën e realizimit të lëndëve, shpërndan kreditet (orët) sipas lëndëve dhe brenda çdo lëndë sipas formës se

	transmetimit (leksione, seminare, forme e kontrollit të vazhdueshëm/praktike profesionale të zhvilluara në auditor). Mungojnë kredite në zërin e laboratoreve, në diskutim me anëtare të departmentit të DIT u shpjegua që kjo është bërë për faktin që seminarët e lëndëve zhvillohen në laboratorë. <i>GVJ mendon se një ndarje e krediteve në formën e laboratorit do të ishte në interesin e studentëve dhe të mbarvajtjes së procesit mësimor dhe të realizimit të objektivave të planit mësimor.</i> [Dok.33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Dok 19 etj. Syllabusët e lendeve.]
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabusët e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.	Bazuar në DVV, program i studimit përmban të gjitha syllabusët e lëndëve të parashikuara në planin mësimor DP “Aplikime Informatike”. Në përgjithësi syllabusët përmbajnë elementet bazë të kërkuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 “PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË” shtojca Nr. 2 “Programi i lëndës”, por në të gjitha mungojnë/ janë të paqarta temat e laboratoreve që trajtohen, temat/fushat e detyrave/projekteve që trajtohen me studentët. Në syllabusin e “Praktikë dhe zhvillim studentit” janë parashikuar të zhvillohen tema në auditor, ndërkohë e tëra kjo lëndë duhet të zhvillohet në kompanitë apo institucione me qëllim për të afruar studentin sa më afër tregut të punës. [Dok.33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Dok 19 etj. Syllabusët e lendeve.]
Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.	Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve, takimit me studentët, konstatohet se në përgjithësi ky program studimi është fleksibël për të mundësuar një formim profesional të studentëve në fushën e IT-së dhe të aplikimeve software. Duhet bërë përpjekje që ky program studimi të orjentohej drejt praktikave profesionale dhe laboratoreve duke i dhënë më shumë peshë aspektit praktik. [Dok.33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Dok 19 etj. Syllabusët e lendeve.]
Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.	Programi i studimit me karakter profesional “Aplikime Informatike” në planin mësimor ka të shënuar ndarje në kredite Leksione-Seminar-Forma të kontrollit të vazhdueshëm/praktik profesionale, për laboratorët nuk ka të shprehura kredite, kjo na pengon për të gjykuar qartë për vendin dhe peshën që u jepet punës konkrete praktike. Në këtë kontekst, GVJ konstaton se formimit praktik të studentëve duhet të ketë një peshë specifike më të madhe në teresinë e formimit të studentit, në përputhje me profilin profesional të programit. Referuar planit mësimor të programit “Aplikime Informatike” rezulton se raporti i orëve teori me praktikë është: 832:392 (1:0.47), raport afer kërkesave të

	Kornizës Europiane të Kualifikimeve dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, <i>por duke mos e plotësuar raportin minimal 1:1.</i> [Dok.31.14. Kurrikula e programit – DP Aplikime Informatike.pdf, 33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Dok 19 etj. Sylabuset e lendeve.]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në DVV, GVJ konstaton se emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite, ngarkesa mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Emërtimi i programit të studimit “Aplikime Informatike” është në përputhje me përcaktimin ligjor për programet profesionale në ligjin 80/2015. Shpërndarja në dy vite akademik dhe numri i krediteve 120 për këtë program studimi është në përputhje me ligjin 80/2015, neni 72, pika 1 për programet e studimit me karakter profesional. Programi i studimit profesional në “Aplikime Informatike”, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike/4 semestra. Një krediti i korrespondon 25 orë mësimore punë të studentit, përbërë nga orë mësimore në auditor (leksione, seminare, punë e pavarur/praktik profesionale) dhe orë për punë individuale të studentit. [Dok.33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf]
Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i programit të studimit konstatohet se emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore i programit të studimit me karakter profesional “Aplikime Informatike”, është i një modeli që e kërkon tregu dhe mundëson studentëve të arrijnë rezultatet e pritshme. Orjentimi më i mirë i programit drejt orëve laboratorike të specifikuara dhe praktikave profesionale drejt kompanive dhe institucioneve do të i jepte me tepër peshë aspektit praktik. [Dok.31.14. Kurrikula e programit – DP Aplikime Informatike.pdf, 33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf]

Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.	<i>Nga analizimi i planit mësimor GVJ mendon se plani mësimor duhet të ishte i detajuar dhe të pasqyronte qartë ndarjen në kredite të ushtrimeve, laboratoreve dhe detyrës së kursit, mbështetur në Udhëzimin 29, datë 10.09.2018, Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, pika 4.</i> Njësia bazë përgjegjëse DIT e programit të studimit, për vitin akademike në vijimësi duhet që ti detajoj planet mësimore, në përputhje me udhëzimet në fuqi. Syllabuset e lëndëve përmbajnë në përgjithësi elementët bazë të kërkuara nga VKM 41 dhe janë informuese në lidhje me aktivitetet kryesore të tyre, leksione, seminare. <i>Mungojnë kreditet e laboratoreve, temat e laboratoreve të trajtuar, Detyra e kursit apo temat, fushat e projekteve.</i> Rekomandojmë që në planin mësimor të jepet sasia e krediteve të parashikuara për laborator, syllabuset të korrigjohen gabimet dhe të jepen temat e laboratorit, temat e detyrave apo fushat përkatëse. [Dok.31.14. Kurrikula e programit – DP Aplikime Informatike.pdf, 33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Dok 19 etj. Syllabuset]										
Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion.	Bazuar në planin mësimor rezulton se kemi këtë shpërndarje të orëve në auditor sipas formave së mësimdhënies: <table border="0"> <tr> <td>- Leksione</td> <td>420 orë</td> </tr> <tr> <td>- Seminare</td> <td>412 orë</td> </tr> <tr> <td>- Ushtrime/Laboratorë</td> <td>0 orë</td> </tr> <tr> <td>- Kontroll i vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale</td> <td>267 orë</td> </tr> <tr> <td>-Praktike profesionale në terren</td> <td>125 orë</td> </tr> </table> <i>Pra kemi një raport teori/praktike 832:392.</i> Në planin mësimor raporti aftësimi praktik/ punë konkrete në profesione (Kontroll i vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale + Praktike profesionale në terren) është 25.5 kredite ose 21.25% e programit. [Dok.31.14. Kurrikula e programit–DP Aplikime Informatike.pdf, 33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Syllabuset]	- Leksione	420 orë	- Seminare	412 orë	- Ushtrime/Laboratorë	0 orë	- Kontroll i vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale	267 orë	-Praktike profesionale në terren	125 orë
- Leksione	420 orë										
- Seminare	412 orë										
- Ushtrime/Laboratorë	0 orë										
- Kontroll i vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale	267 orë										
-Praktike profesionale në terren	125 orë										
Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut	Raporti midis formimit teorik dhe atij praktikë duhet të rritet në drejtim të atij praktik për të plotësuar kërkesën ligjore (50/50), që për këtë program studimi, është 94.5 kredite leksion+seminare: 25.5 kredite kontroll i vazhdueshëm/praktike profesionale dhe lënda e Praktikës profesionale në terren.										

e punës.	[Dok.31.14. Kurrikula e programit – DP Aplikime Informatike.pdf, 33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.3

Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktivitetëve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	Programi i studimit me karakter profesional “Aplikime Informatike” përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktivitetëve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit. <i>Në planin mësimor duhet të jepen të ndara veç kreditet e laboratorëve, si dhe të jepen kreditet e detyrës së kursit në syllabuset përkatëse.</i> 33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf]
Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.	Lëndët e vendosura në planin mësimor të këtij programi studimi me karakter profesional “Aplikime Informatike” janë lëndë të përshtatshme për formimin e një tekniku të mesëm me orjentim drejt tregut të IT-së, zhillimit bazik të programeve dhe mirembajtjes së tyre. Materialet mësimore për lëndët e profesionit janë të përgatitura nga pedagogët e lëndës përkatëse, reference syllabuset. <i>Gjithashtu literatura e dhënë në disa prej lëndëve profesionale nuk është e pesë viteve të fundit, referencë syllabuset.</i> [Dok 19 [1-22]. Syllabuset]
Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjes e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.	Referuar dosjes së programit të studimit, përkatësisht përmbajtjes së tij, GVJ konstaton se gjatë zhvillimit të programit të studimit, studentët zhvillojnë aftësi profesionale nëpërmjet ndërthurjes së elementeve të studimit teorik dhe forms së kontrollit të vazhdueshëm/praktik profesionale. Metodat kryesore të mësimdhënies janë leksione, kontrolli i vazhdueshëm/praktike profesionale. Vlerësimi i lëndëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme sipas dy tipologjive të lëndëve: -Lëndë të tipologjisë së I-rë, provimi përfundimtarë 40%, detyra 60% - Lëndë të tipologjisë së II-të provimi përfundimtarë 40%, provimi ndërmjetëm 30%, detyra e kursit 20% dhe aktivizimin e seminarit 20 %. [Dok.7 Rregullorja e programit të studimit]
Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e	Në këtë program të studimit me karakter profesional, lëndët bazë si

formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	komunikim profesional dhe ato ndërdisiplinore integruese si: Hyrje ne filozofi, Hyrje në administrim biznes, Shkrim akademik, u mundësojnë studenteve përfitim e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës. [Dok. 33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese, Syllabuset]			
Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Nga shqyrtimi i dosjes DVV rezulton se institucioni UET ka marrëveshje me kompani dhe institucione vendase dhe të huaja. Në planin mësimor është parashikuar një lëndë me 5 kredite për të mundësuar studentëve të aftësohen për punë në kompani apo institucione. Në rregulloren e programit të studimit është përcaktuar procedura dhe detyrat e ndjekjes së studentëve në zhvillimin e praktikës profesionale. Syllabusi i lëndës “Praktikë dhe zhvillim student” nuk është në harmoni sa më sipër, ai parashikon zhvillimin e temave në auditor, rekomandohet të rishikohet dhe të vendosen qartësisht objektivat dhe rezultatet e pritshme në harmoni me planin mësimor, strategjinë e zhvillimit të tij dhe rregullores së programit të studimit. [Dok. 33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese, Syllabuset]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.	Referuar Statutit dhe Rregullores së UET-së, GVJ konstaton se është përcaktuar qartë struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në UET, që është Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), për monitorimin e cilësisë dhe zhvillimin e mekanizmave të cilësisë, bazuar në rregulloren e saj. Nga takimi me KSBC dhe titullarin e departamentit, stafin akademik dhe studentet, GVJ konstatoi se KSBC bashkëpunon ngushtë me Fakultetin, departamentin përgjegjës për programin e studimit në fjalë. KSBC së bashku me përgjegjësit e departamenteve dhe grupe të ndryshme Ad-hoc organizojnë monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësim nxënies në të gjithë elementët e saj si në procesin e leksioneve, seminareve, punëve laboratorike dhe praktikës profesionale, sipas planit të punës të përcaktuar. GVJ konstati se KSBC zhvillonte mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies, metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Kjo realizohej nëpërmjet Pyetësorëve / anketimeve vlerësuese për çdo lëndë nëpërmjet sistemit LMS, ku studentëve iu jepej të shpreheshin në mënyrë të lirë dhe të pavarur duke ruajtur anonimin. Rezultatet e këtyre vlerësimeve pasi grupoheshin dhe analizoheshin përbënin objekt analizë në nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti. Nëpërmjet KSBC, UET rezultoi se ka të organizuar në mënyrë funksionale sistemin e brendshëm të cilësisë, i cili funksionoi si më poshtë: Kryen rolin e monitorimit, të gjithë aktivitetit mësimor, duke mbikëqyrur procesin e mësimin në të gjitha elementët e tij, duke mbledhur informacione dhe evidentuar probleme të ndryshme. Realizon mbështetje dhe ekspertizë, që synon evidentimin e problemeve që në fazën e lindjes se problemeve të procesit mësimor, me qëllim që të parandalohen zgjatja e tyre. Kryen rolin e bashkërenduesit, i cili realizohet nëpërmjet një procesi koordinimi të realizimit të gjitha detyrave dhe objektivave që kërkohet të realizohet jo vetëm nga një njësi (departament, apo fakultet), por edhe nga njësitë e tjera të fakultetit apo dhe universitetit. Bën monitorimin e procesit, i cili aplikohet duke studiuar metodat dhe metodologjitë më të përparura të procesit të mësimdhënies dhe mësim nxënies dhe duke organizuar punën më stafin dhe organet drejtuese për ti zbatuar ato metoda, teknika me efektivitet

	dhe eficiencë. Bën interpretimin e të gjithë legjislacionit dhe dokumenteve të ndryshme udhëzuese/dokumentave, lidhur me sigurimin e cilësisë. Administron dokumentacionin lidhur me planifikimin, kontrollin e zbatimit dhe përmirësimit të cilësisë. [Dok. Statuti i UET; Plan strategjik i zhvillimit të programit të studimit; Formulimi i vlerësimit të pedagogut.]
Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.	Format kryesore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, detyra e kursit, praktikat profesionale mbështetur në dokumentacionin e vënë në sistem dhe nga takimet e realizuar me stafin dhe studentët gjatë vizitës në institucion. Gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 dhe i gjithë viti akademik 2020-2021 janë zhvilluar dhe leksionet dhe ushtrimet online duke shfrytëzuar platformën online LMS dhe Microsoft Teams, nëpërmjet portalit të vendosur në faqen zyrtare web të Institucionit, https://lms.uet.edu.al/ Të gjitha këto forma janë të përshtatshme për të realizuar këtë program studimi me karakter profesional, në kushtet e pandemisë. [Dok. Dosja e DVV, web site zyrtar i UET https://lms.uet.edu.al/]
Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	Personeli akademik i këtij programi studimi përdor forma dhe mënyrat tradicionale të mësimdhënies nëpërmjet shpjegimit në tabelë, shpjegimit me powerpoint. Gjatë vizitës në institucion nga biseda me pedagogët dhe studentët na u tregua se një metodë efektive e mësimdhënies ishte ajo interaktive pedagog-student, që përdorej më shumë gjatë orëve të ushtrimeve apo të kontrollit të vazhduar, sidomos në profilin e sistemeve kompjuterike. Për t'ju përgjigjur nevojave të mësimdhënies për shkak të situatës së Covid 19 mësimi në prej semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 dhe në vijim është zhvilluar plotësisht online në përgjigje të nevojave të studentëve. Kjo gjë është e pasqyruar dhe në faqen zyrtare web https://lms.uet.edu.al/.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.	Bazuar në dokumentacionin e dosjes së DVV, personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie si ai PAE dhe PAK ka kualifikimin e nevojshëm mbështetur në legjislacionin në fuqi. Ato janë kompetentë në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit. Mbështetur në CV e vendosura në sistem, janë specialist të fushave përkatëse dhe kanë përvojë në mësimdhënie. [Dok. Dosja, DVV, CV e stafit 59-86]-\
Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë	Nga takimi me stafin akademik të departamenti DIT, GVI konstaton se institucioni mbështet stafin me qëllim kualifikimin e mëtejshëm të tij, duke nxitur dhe mbështetur financiarisht

dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	pjesmarrjen në konferenca dhe takimi kualifikuese. Insitucioni organizon shpesh orë leksioni të hapura dhe workshope me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies si dhe të fuqizimit të mardhënieve me kompani apo institucione të tjera. [Dok. 33 Të dhëna mbi trajnimet profesionale]			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	GVJ, mbështetur në dokumentacionin përkatës, vizitën në institucion dhe RVB, konstaton se UET ka në dispozicion të procesit mësimor infrastrukture fizike dhe zhvillon veprimtarinë e akademike dhe administrative, përkatësisht: në godinat qendrore në Bulevardi Gjergj Fishta, Tirana. Godinat në të cilat zhvillohet procesi i mësimdhënies, janë godina të mirembajtura me standarde të larta ndërtimore si dhe që përbushin kriteret për zhvillimin e aktiviteteve mësimore. Ambientet ku zhvillohet kërkimi, mësimi dhe zyrat, të cilat u panë gjatë vizitës në vend, janë të pajisura në përshtatje me funksionin që ato kryejnë, të ndriçuara maksimalisht, me akustikë të përshtatshme, me sistem individual kondicionimi dhe me inverter për ngrohje dhe ftohje. Auditorët për mësimdhënie janë të pajisura me projektorë, me qasje në internet nga çdo vendndodhje në hapësirën e godinës. Ambientet janë të pajisur me sistem mbrojtës kundra zjarrit të lëvizshëm dhe statik, me mjetet e nevojshme të ndihmës së shpejtë për çdo kat, me furnizim të pandërprerë me ujë falë depozitave të ujit me vëllim të mjaftueshëm, me sistem alternativ në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike nga rrjeti dhe me ambiente të shërbimit për nevoja personale në çdo kat. [Dok. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit]
Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Bazuar në DVV, viziten në institucion, takimin me pedagogët, studentet, GVJ konstaton se UET përdor sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve LMSI apo UMSI. Sistemi i Menaxhimit të të dhënave mundëson menaxhimin e integruar të tyre për programet akademike dhe kurikulat përkatëse, stafin akademik dhe studentët. Sistemi është një platformë e integruar bazuar në një arkitekturë modulare duke krijuar mundësinë e personalizimit të tij sipas nevojave dhe specifikave të UET-se. Sistemi menaxhon të dhënat e studentëve që kanë frekuentuar

	ose frekuentojnë një program studimi që ofron Universiteti. Sistemi i IT-së është i personalizuar për të kryer funksione të ndryshme të menaxhimit të procesit mësimor, të menaxhimit të sekretarisë dhe elementë të tjerë të menaxhimit. Pedagogët hedhin në sistem syllabuset, materialet didaktike, mungesat e studenteve dhe vlerësimet vjetore. Nga ana tjetër studentët mund të shohin ecurinë e tyre vjetore direkt në sistem përgjatë të gjithë vitit. [Dok. 42 Infrastruktura në funksion të programit të studimit; https://lms.uet.edu.al/]
Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë në shumicën e lëndëve karakterizuese janë leksione dhe libra të pedagogëve të lëndës, që u vihen në dispozicion studentëve të printuara ose në formë elektronike. Në bibliotekën e UET ka një numër të caktuar librash të dhëna si referencë. <i>Kjo bibliotekë duhet të pasurohet me libra të tjerë teknikë si në gjuhën shqipe ashtu dhe në atë të huaj.</i> Institucioni ka vënë në dispozicion librari elektronike me kontratë si: Questia, Sage, Ebsco dhe librari të tjera online free. [Dok.45 Inventari i teksteve në fushën e programimit.]
Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Nga vizita në bibliotekë, takimi me studentët GVJ konstatoi se biblioteka mundëson aksesin në libraritë online si për personelin akademik, ashtu edhe për studentët. Staf i bibliotekës ofron mbështetje gjetjen e burimeve on-line të kërkuara. Biblioteka është e pajisur me PC, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UET-ja. Pedagogët dhe studentet përdorin gjithashtu portale dhe biblioteka, aksesimi në të cilat është falas (referencë RVB). [Dok. RVB, DVV, Vizita në institucion]
Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe vizita në institucion konstatohet se UET, për shkak dhe të programeve në shkencë aplikative që ofron, ka infrastrukturë laboratorike që shfrytëzohet nga studentët për realizimin e orëve laboratorike, detyrave të kursit apo diplomave. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me kompjutera normal dekstop me programet e nevojshme të përcaktuara në programet mësimore.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Të detyruar nga kushtet e pandemisë gjatë gjithë semestrit të dytë të vitin akademik 2019-2020 dhe tërësisht viti akademik 2020-2021 është zhvilluar online, në funksion të mësimdhënies janë përdorur platformat online të Microsoft Teams dhe LMSI për zhvillimin e leksioneve dhe ushtrimeve. Për këtë është shfrytëzuar portal i institucionit, me guidat përkatëse për stafin dhe studentët. [Dok. https://lms.uet.edu.al/]

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Struktura kryesore e institucionit, në nivel institucional, që ndjek, monitoron dhe vlerëson procesin e mësimdhënies është "Zyra për Kontrollit e Brendshëm të Cilësisë" KSBC. Gjatë vizitës në Institucion, në takimin e zhvilluar me drejtuesen e KSBC na u sqarua se kjo njësi në mënyrë periodike ushtron kontrollon lidhje me mësimdhënien, prezencën e studentëve në mësim, cilësinë e mësimdhënies, cilësinë e syllabuseve dhe zbatimin e standarteve sipas kornizës ligjore në fuqi. Kjo zyre bashkepunon ngushte me drejtuesit njesive kryesore dhe njesive baze, me qëllim të evidentimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. [Dok.2 Statuti UET ;8 Mbi sigurimin e brendshem te cilesise;30 Plani i veprimit te KSBC]
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës (njësi kryesore) dhe Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë (njësi bazë) janë përgjegjëse për programin e studimit dy vjeçar DP "Aplikime Informatike". Në funksion të mbarëvajtjes të procesit mësimor janë të angazhuar këshilltarët akademikë, përgjegjësit e departamenteve dhe deri tek Dekani i Fakultetit. Këto struktura nxisin, promovojnë dhe orientojnë personelin akademik në rritjen e cilësisë së programit të studimit. Strukturat nxisin studentët që të jenë pjesë e procesit të evidentimit të problematikave me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. [Dok. 6 Mib organizimin dhe funksionimin e Dekanatit, Departamneteve; 41 Formulari i vetevleresimit te performances se personelit akademik]
Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.	Gjatë vizitës në institucion, në takimin e zhvilluar me anëtarët e departamenti DIT dhe drejtuesit e njesisë kryesore u konstatua se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik të angazhuar në këtë program studimi kanë përgjegjësinë kryesore dhe janë angazhuar për një mësimdhënie cilësore. Pjesa me e madhe e stafit ka përvojë të gjatë në mësimdhënie dhe kishte në dëshirë të madhe nga ana e stafit për të ndihmuar studentet e këtij programi studimi në çdo aspekt, kjo u konfirmua edhe nga diskutimet me studentët.
Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse	Gjatë vizitës në institucion, në takimin e zhvilluar me anëtarët

mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.	e departamenti DIT dhe drejtuesit e njesisë kryesore dhe KSBC, u evidentua fakti që konceptimi i procesit mësimor është bërë duke synuar vënien e studentit në qendër. Kjo kishte sjellë ndryshim nga metoda tradicionale, duke i dhënë më shumë mundësi pjesëmarrjes në diskutime dhe pyetje studentit. Zhvillimi i orëve interaktive, të cilat ndërthurin shpjegimet në nivel teorik dhe empirik, duke u përqendruar në bashkëveprime të vazhdueshme midis profesorit dhe studentit, nxitja e debateve, mendimit kritik, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet e punimeve janë disa prej mjeteve kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në mënyrë aktive në procesin mësimor. Gjithashtu një lehtësi ishte edhe sistemi LMS. [Dok .46 Manuali i përdoruesit UMSI.]			
Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik u adoptua shpejt me metodat e reja të mësimdhënies online përgjatë vitit aktual akademik, kjo e dhënë u deklarua nga drejtuesi i departamentit dhe pedagogët gjatë takimit të realizuar me to në institucion. Gjithashtu edhe eksperiencat në Universitete homologe evropiane në kuadër të programit Erasmus kanë rritur cilësinë e mësimdhënies. Metodatat e reja të mësimdhënies, nëpërmjet seminareve të dedikuara, leksioneve të hapura workshope etj, janë bërë të njohur në të gjithë trupën akademike të UET, me qëllim përmirësimin e këtij procesi në vijimësi. Përfshirja e studenteve dhe vjelja e mendimit të tyre në kuadër të përmirësimit të cilësisë së personelit akademik dhe metodave të mësimdhënies ka qenë dhe është periodik për të gjitha aspektet akademike dhe administrative të UET. [Reference, Takimi me stafin akademik]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale është i përcaktuar në rregulloren e programit të studimit dhe në dokumenta të tjera tranzitore të situatës së zhvillimit të mësimin online. Vlerësimi bëhet në bazë të tipologjisë së lëndës duke kombinuar kontrollin e vazhdueshëm dhe atë përfundimtar, në çdo rast ruhet dokumentacioni sipas rregullores dhe studentet kanë të drejtën e ankimimit dhe të rishqyrtimit të vlerësimit, kjo u

	konfirmua edhe nga studentet gjatë takimit. [Dok. 7 Rregullore mesimore e programit te studimit, kreu 5.]
Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në DVV, diskutimi me drejtuesene njësisë bazë (DIT), vlerësimi i lëndëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme sipas dy tipologjive të lëndëve: -Lëndë të tipologjisë së I-rë, provimi përfundimtare 40%, detyra 60% -Lëndë të tipologjisë së II-të, provimi përfundimtare 40%, provimi ndërmjetëm 30%, detyra e kursit 20% dhe aktivizimine seminar 20 %. Nga takimi me studentet u evidentua se në përgjithësi mënyra e vlerësimit ishte efikase dhe e përshtatshme për kohën e pandemisë. [Dok.7 Rregullorja e programit të studimit, 5.2-3 <u>Rregullore tranzitore mbi vijimin e procesit akademik gjate semestrit te pare te vitit akademik 2020-2021ne kushtet e pandemise COVID-19.pdf</u>]
Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës /modulit.	Pedagogu i lëndës informon studentët në fillim të vitit akademik në lidhje me syllabusin e lëndës, ku jepet informacion në lidhje me metodologjinë e testimit dhe vlerësimin e njohurive dhe dijeve të parashikuara për lëndën përkatëse, kjo e dhënë u deklarua nga drejtues i departamentit dhe pedagogët gjatë takimit të realizuar me to në institucion. Gjithashtu të dhëna, studentët marrin nga kordinatorja e programit te studimit si edhe nëpërmjet sistemit LMS, për të cilën disa student kishin edhe rezerva .
Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimin, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik duke zhvilluar provime me shkrim dhe provime me gojë, referencë nga syllabuset. Gjatë semestrit te dyte te vitit akademik 2019-2020 dhe vitit aktual provimet ishin zhvilluar në sistemin Microsoft Teams dhe LMS. [Dok. kalendari veprimtarise akademike, 2019-2020 dhe 2020-2021]
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale për lëndët e zhvilluara në këtë program studimi me karakter profesional realizohet nga pedagogu i lëndës. Në përfundim të provimit studentët sqarohen nga pedagogu i lëndës mbi zgjidhjet e mundshme dhe provimet e radhës. Studentët informohen me email për vlerësimin e provimit. Ky informacion është marrë në institucion gjatë takimit të zhvilluar me pedagogët si dhe DVV. [Dok. 7 Rregullore mesimore e programit te studimit]
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve	Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale jane të

dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.	rregulluara sipas rregullores themelore të UET, neni 30 dhe në vijim. Provimet që zhillohen në auditor zhvilloheshin të sekretuara dhe rezultatet e tyre jepen brenda 2 javëve. Studentet në çdo rast njihen me vlerësimin përgjatë seancave sqaruese dhe raste të rishikimit apo ankimimit të provimit ndiqnin procedurën e përcaktuar për ankimim deri tek drejtuesi i njësive kryesore Dekani. Gjatë takimit me studentët u konstatua se në përgjithësi ky proces kishte funksionuar dhe studentët në përgjithësi ishin të kënaqur me këtë sistem. Studentet kishin pretendime për sistemin e provimit online dhe ate LMS. [Dok. Rregullore e UET, neni 27-32]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim të njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënës për programet me karakter profesional.	Nga shqyrtimi i DVV, takimeve me stafin akademik dhe përgjegjës të departamentit, GVJ konfirmon se mënyra e hartimit të programit të studimit Aplikime Informatike dhe përmbajtja e programeve (syllabuseve) të studimit synon të garantojë përfitim të dijes, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit "Aplikime Informatike", në përputhje me kornizën Shqiptare të kualifikimit niveli 5, pasi ofrojnë njohuri të thelluara praktike dhe profesionale. Përfitimi i këtyre njohurive kalon nepermjet disa fazave duke filluar me koncepte bazë të fushës së studimit, formim qytetarie të përgjithshëm, koncepte që lidhen me profesionin dhe licensimin profesional, aftësim bazë dhe kërkimor, aftësim profesional të fushës së studimit dhe aftësim për promovim personal. [Dok.31.14. Kurrikula e programit – DP Aplikime Informatike.pdf, 33 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Dok 19 etj. Syllabuset]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.	Duke analizuar planin mësimor dhe kurrikulen e programit të studimit konstatohet se ky program i studimit me karakter profesional ka lëndë si Hyrje në Informatikë, Filozofi, Administrim Biznes të cilat japin njohuri të përshtatshme në fushën e teknologjisë së informacionit, shkencave humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. Programi ka një sërë lëndësh të formimit profesional: elektronike, programin, arkitekturë kompjuteri, bazat e të dhënave etj. Të gjitha këto njohuri të marra ndihmojnë që studentët të komunikojnë në mënyrë profesionale, të bëjnë diskutime në grup

	dhe të realizojnë zgjidhjen e problematikave të caktuara që dalin në punën e përditshme. [Dok.31.14. Kurrikula e programit – DP Aplikime Informatike.pdf, 33 Plan i mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – DP Aplikime Informatike.pdf, Dok 19 etj. Syllabuset]
Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.	Nga diskutimet me drejtuesit e njesisë bazë dhe kryesore u konstatua se synimi i këtij programi studimi ishte fokusi kryesor, aftësimi i kopetencave praktike të studentëve. Njohuritë e përfituara në auditor synohen të testohen dhe zhvillohen më tej jo vetëm në laboratorët e IAL por edhe gjatë praktikave profesionale efektive në punëdhënësit dhe aktorët e biznesit duke bërë të mundur përfitimin e aftësive dhe formimit praktik të studentëve. Personeli akademik i lëndëve kryesore të formimit profesional shërbyer si tutor dhe koordinator të praktikave profesionale të studentëve me kampanitë dhe bizneset. Programi studimit me karakter profesional është program i ri studimi, për këtë arsye nuk ka mobilitet të studentëve me institucionet bashkëpunuese. [Dok 28 Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf]
Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.	Nga dosja e DVV dhe takimet e zhvilluara në institucion, GVJ evidenton faktin se në UET, mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Në përfundim të çdo lënde, organizohet provimi, nga pedagogu i lëndës, i cili vlerëson, analizon dhe shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në syllabusin e lëndës. Ky program studimi është i ri, në vitin akademik 2019-2020 ka nxjerr të diplomuarit e parë, prandaj mendojmë që eksperiencia e krijuar në këto tre vite akademike do të ndihmojë në orientimin e studentëve për zbatimin në prokatikë të njohurive të përfituara.
Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.	Diplomimi për këtë program studimi me karakter profesional realizohet me provim formimi ose me një projekt profesional. Procedurat për diplomimin e studentëve jepen në rregulloren bazë të UET, kreu IX, nenet 38-41, studentet orjentohej nga kordinatori i programit të studimit dhe drejtuesi i njesisë bazë, gjithashtu edhe pedagogët japin ndihmesën e tyre në kete proces. Në sekretarinë mësimore kishte regjistër zyrtar të studentëve, që ndjekin studimet në këtë program studimi konform udhëzimeve të MAS. [Dok. Rregullore e UET, Vizita në institucion]
Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë	Studentet e programit dyvjeçar të "Aplikime Informatike" kanë në program realizimin e punimit të diplomës i cili është i

orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.	planifikuar të realizohet në fund të semestrit të katërt (pra në fund të vitit të dytë). Tema e diplomës përzgjidhet që në fillim të semestrit të katërt. Tematika e diplomës është rezultat i zgjedhjes së studentit. Departamenti cakton një udhëheqës shkencor që është dhe njohës i fushës së temës. Puna për realizimin e temës zgjat një semester dhe i nënshtrohet konsultimeve dhe kontrolleve nga udhëheqësi i temës por edhe nga Departamenti. Mbrojtja e temës bëhet përpara një komisioni të propozuar nga përgjegjësi i departamentit dhe të miratuar nga Dekani. Gjithashtu një pjesë e studenteve mund të zgjedhin "Provimin e Përgjithshëm Përfundimtar" (PPP) i cili bazohet në kontrollin e njohurive të fituara në lëndë të kategorisë B. Në përgjithësi studentët preferonin të realizonin një temë e mbeshtetur në një projekt specifik. [Dok.7 Rregullore e programit të studimit, Aplikime Informatike]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.	Zyra e Burimeve Njerësore, si njësi përgjegjëse për zbatimin e procedurave të institucionit në lidhje me rekrutimin e stafit akademik dhe jo vetëm, ka një rregullore të mirëpërcaktuar në lidhje me dokumentacionin dhe procedurat për rekrutim të stafit. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion gjatë vizitës në institucion dhe në veçanti në zyrën e Burimeve Njerësore, shohimi se institucioni ka një procedurë të brendëshme për përcaktimin e nevojave për angazhim stafi të ri dhe më pas për rekrutimin e tij. Kërkesa fillestare për shtimin e stafit akademik vjen nga përgjegjësi i njësisë bazë, në lidhje me nevojat për mbulimin e të gjithë aktivitetit didaktik të parashikuar për programet e studimit të mbuluara nga njësia bazë. Është njësia bazë që harton edhe kriteret specifike që duhet të përmbush stafi akademik. Zyra e burimeve njerësore ndjek procedurat administrative të aplikimeve dhe vlerëson paraprakisht përputhshmërinë e aplikimeve me kriteret. Institucioni nuk ka një format vlerësimi standard për aplikantët për staf akademik. Vlerësimi bëhet çdo herë nga komisioni ad-hoc i ngritur për vlerësimin e kandidaturave. Nuk ka një skedë pikëzimi bazuar në kriteret të qarta të vlerësimit të kandidatëve. [11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerësore] [11.1. Shembull thirrje për staf akademik] [dok. Gjatë vizitës në institucion]
Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.	Institucioni i Arsimit të Lartë UET ka në organikën e tij zyrën e Burimeve Njerësore. Kjo zyrë është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve njerësore, GVJ konstatoi se kjo zyrë dispononte të dhëna mbi anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në programin e studimit. Në shqyrtimin e tre dosjeve rastësore të personelit të angazhuar në programin e studimit, u vu re plotësia e dokumentacionit sipas kërkesave ligjore. Dokument i pa azhornuar ishte vetëm CV e personelit e cila ishte dokument i dorëzuar në momentin e aplikimit fillestar si personel pranë UET, modifikime të mëvonshëm të këtij dokumenti nuk paraqiteshin në dosje. Nga personeli shpjegohet se në dosje azhornohen dokumentacionet ligjore, ndërsa CV e azhornuar

	rruhet në format elektronik dhe nuk reflektohet në dosje (hard copy) për të mos rritur vëllimin e saj. Stafi akademik i angazhuar pranë institucionit, punësohet me kontratë me afat të caktuar konform kodit të punës dhe akteve rregullatore në fuqi. Bazuar në këto të dhëna hartohen edhe të dhënat tabelore të përvitshme për angazhimin e stafit akademik të të gjithë institucionit dhe në veçanti atij të angazhuar në këtë program studimi. [23. Te dhena tabelore per personelin akademik ne njesine kryesore dhe njesine pergjese.pdf] [24. Te dhena Tabelore per stafin mesimdhenes per programin e studimit (Aneks Tabelat 6_7_8_12).pdf]
Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	UET, me njësitë bazë, caktojnë nevojat e angazhimit të stafit akademik në programet e studimit të ofruara nga institucioni. Nga ana procedurale përmbushen kriteret si dhe impenjimi i institucionit, por nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se ka vend për përmirësime. <i>Në veçanti, referuar tabelës 2 në RVB në lidhje me personelin akademik të "Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë", përgjegjës për programin e studimit "Diplomë Profesionale Aplikime Informatike" vihet re një angazhim i ulët i këtij stafi në këtë program studimi (më pak se 50% e aktivitetit didaktik në auditor mbulohet nga ky departament).</i> Për më shumë detaje i referohemi tabelave 12.1, 12.2 dhe 12.3 në RVB "Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës" për tre vitet e fundit akademike vihet re se ngarkesa mësimore e lëndëve për programin e studimit është e shpërndarë sipas departamenteve si: 41/120 ECTS = 34% mbulohen nga "Qendra për Metodologjinë dhe Kërkimin Shkencor" 57/120 ECTS = 48% mbulohen nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë 11/120 ECTS = 9% mbulohen nga Departamenti i "Shkencave Humane dhe Komunikimi" 6/120 ECT = 5% mbulohen nga Departamenti "Menaxhim dhe Marketing" 5/120 ECST = 4% detyrime përmbyllëse (Praktikë) që nuk ka angazhim në auditor Pra rreth 50% e aktivitetit didaktik mbulohet nga personeli PAE/PAK i departamentit përgjegjës për programin e studimit dhe pjesa tjetër nga staf akademik i departamenteve të tjera të institucionit, me një peshë 34% të Qendrës për Metodologjinë e Kërkimit Shkencor. Edhe pse personeli akademik i angazhuar ka formimin e kërkuar për programin e studimit, departamenti përgjegjës për programin e

	studimit duhet të ketë angazhim më të madh në formimin e studentëve të këtij profili. Pasi një riorganizimi i departamenteve të tjera të institucionit, prek në mënyrë të ndjeshme edhe këtë program studimi. [24. Te dhena Tabelore per stafin mesimdhenes per programin e studimit (Aneks Tabelat 6_7_8_12).pdf] [25. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik (Aneks Tabela 4).pdf] [5. Plani mesimor DP Aplikime Informatike.xlsx]			
Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni inkurajon përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Kjo vërehet edhe në trajnime të brendshëm të zhvilluara si dhe në kuadër të situatës së pandemisë të krijuar nga Sar-Cov-19 (Covid-19) ku institucioni ka hartuar edhe video trajnime në lidhje me përdorimin me efikasitet të platformave online. Gjithashtu, institucioni inkurajon edhe pjesëmarrjen e stafit akademik në projekte ndërkomëbtare në të cilat institucioni është i përfshirë ose parashikon të përfshihet në të ardhmen. [33. Të dhëna për trajnimet profesionale.pdf] [46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf] [46.2 UET LMS Guide per pedagogun.pdf] [46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMSLMS.pdf] [43.1 Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se UET siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse. Sallat e leksioneve dhe të seminareve janë të pajisura me infrastrukturë ndihmëse si PC, projektor etj. Prania e ambienteve ndihmëse si bar-restoranti (vlerësuar si një ndihmë e madhe nga studentët) si dhe salla e konferencave, garantojnë ambientet e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë akademike dhe jo vetëm pranë këtij institucioni. [42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.pdf]
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si:	Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet si salla leksionesh

klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjediset ndihmëse. Sallat e leksioneve dhe seminareve ishin të pajisura me video-projektor dhe PC fiks në ndihmë të procesit mësimor. Edhe salla e konferencave me një kapacitet prej rreth 70 persona ishte e pajisur me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit në dispozicion të procesit didaktik dhe jo vetëm.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Bazuar edhe në programin e studimit objekt e kësaj RVJ-je, "Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni", laboratorët e nevojshëm janë kryesisht laborator të teknologjisë së informacionit. Në Institucion u vizituan katër laboratorë informatike: Lab 205: Përmban 25 PC + 1 video projektor; Lab 206: Përmban 35 PC + 1 video projektor; Lab 207: Përmban 35 PC + 1 video projektor; Lab 208: Përmban 80 PC + 1 video projektor; Softuer të instaluar në këto laboratorë janë në përputhje me plan-programet e lëndëve dhe në funksion të formimit të përgjithshëm dhe specifik të studentëve të këtij program studimi. U vizitua edhe një laborator i realitetit të shtuar (Augmented reality) i cili kishte pajisje multimediale dhe vizioni 3D të cilat përdoren nga studentët për projekte specifike në bashkëpunim me pedagogët e departamentit.
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	institucioni, sikurse përmendet edhe në Kriterin 3 më sipër, ka në dispozicion katër laborator informatike të pajisur me programe profesionale në funksion të aktivitetit didaktik dhe programeve të studimit që ofron. Nga vizita në institucion, na u konfirmua se laboratorët mund të aksesohen nga studentët edhe përtej orarit didaktik të lëndëve përkatëse dhe ti përdorin ato për punimin e detyrave/projekteve të kursit, në veçanti laboratori 208 që shërben edhe si sallë interneti.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	Institucioni falë memorandumeve të bashkëpunimit me institucione, korporata dhe biznese, garanton mundësinë e zhvillimit të praktikave mësimore profesionale si pjesë e integruar e programit të studimit [Dok. 34.1 – 34.11. Memorandum bashkëpunimi UET me ...]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarrëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, IAL UET disponon një bibliotekë me sipërfaqe rreth 300m² të pajisur me një fond të konsiderueshëm librash, kryesisht në gjuhën angleze por jo vetëm. Gjithashtu biblioteka ka një seksion të dedikuar edhe për literaturën e prodhuar nga vet institucioni apo me mbështetjen e tij. Qasja në bibliotekë është e lirë, dhe ka mabiente të bollshme për të përdorur literaturën në ambientet e saj. Gjatë sezonit të provimeve Biblioteka punon me orar të zgjatur, ndërsa orari normal i saj është: E hënë – E premte 09:00 – 20:00 dhe E shtunë 09:00 – 17:00 [42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.pdf] [https://uet.edu.al/new/en/sherbimet/]
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka është e pajisur me literaturë fizike kryesisht në gjuhën angleze. Mungesa apo literatura e vogël në gjuhën shqipe shihet si pengesë për përçimin e dijeve në studentët e këtij programi studimi. Pedagogët, megjithatë, e shohin më të udhës rritjen e njohurive në gjuhën angleze të studentëve sesa shtimin e literaturës në gjuhën shqipe. Kjo është edhe specifike për drejtimin e këtij programi studimi, ku e gjithë terminologjia e përdorur në praktikën profesionale e më pas në ambientet e punës ku këta student mund të angazhohen, është e gjitha në gjuhën angleze. Gjetja e librave në gjuhën shqipe për këtë program studimi, duke qenë ai dinamik dhe në evolucion shumë të shpejtë në rang botëror, do të sillte literaturë të vjetërsuar për vetë kohën që një literaturë në këtë fushë kërkon që të përkthehet/përshtatet në gjuhën shqipe. [8. Lista e titujve - Informatikë_TIK.xlsx]
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni garanton qasje në bibliotekën fizike, por gjatë vizitës në institucion, dhe më saktësisht, takimi me studentët, studentët pohuan se nuk janë në dijeni nëse institucioni ka qasje në biblioteka online. Megjithatë, në tabelën 17 në RVB, institucioni paraqet si mundësi të përdorimit të 4 bibliotekave online, dy prej të cilave me afat abonimi 5 vjeçar dhe 2 pa afat. Nuk ka të dhëna nëse qasja në këto biblioteka ka edhe literature e lidhur me profilin e këtij programi studimi, kjo pasi ato janë baza të

	dhënash me profile shumë të gjerë dhe abonimi në to është i pamundur dhe i panevojshëm që të përfshijë të gjitha tipologjitë. Edhe gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me studentët, u vu në dukje se materialet bibliografike janë kryesisht ato të vëna në dispozicion nga pedagogët e lëndëve apo që gjenden edhe në bibliotekën fizike, por nuk kanë kredenciale për biblioteka online. Kjo konfirmohet edhe në tabelën 17 në RVB ku vet institucioni në kategorinë e platformave që mund të përdoren online, shton sëbashku me bibliotekat edhe sistemin e menaxhimit të mësimi (UET LMS) apo edhe atë të menaxhimit të universitetit (UET UMS). [0.2. Tabela aneks permbledhese.pdf]
Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.	Institucioni falë memorandumeve të bashkëpunimit me institucione, korporata, biznese dhe universitet, garanton mundësinë e zhvillimit të praktikave mësimore profesionale si pjesë e integruar e programit të studimit [Dok. 34.1 – 34.11. Memorandum bashkëpunimi UET me ...]
Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.	Bazuar në RVB dhe vizitën në Institucion, IAL UET bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik (janar-dhjetor). Raporti i auditit, përmban të gjitha detyrimet sipas dhe të ardhurat sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. Megjithatë nuk ka të dhëna mjaftueshëm për këtë program studimi specifik. [3. Ekstrakt - Raport auditimi viti 2019.pdf]
Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.	Në dispozicion për GVJ është vënë një ekstrakt raporti i auditimi për vitin fiskal 2019. Ky është një raport përmbledhës ku audituesi raporton për të gjithë Shoqërinë tregtare "European Education Initiative" sh.p.k. Vazhdueshmëria financiare garantohej kryesisht nga tre burimet të ardhurash, tarifat për dhe gjatë shkollimit, donacionet si dhe nga aktivitetet tregtare të institucionit. Gjatë vizitës në institucion, sidomos në takimin me stafin akademik dhe me autoritetet drejtuese, u përmend fakti që institucioni garanton vazhdueshmërinë e programeve të studimit, edhe kur ato nuk janë rentabël në vetvete por i shërbejnë objektivave afatgjatë të institucionit apo edhe si investime për emrin e mirë të institucionit. [3. Ekstrakt - Raport auditimi viti 2019.pdf]

	[0.2. Tabela aneks permblledhese.pdf] [dok. Shënime në vizitë].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni ka të miratuar në rregulloren e tij të përgjithëshme politikat dhe procedurat për çdo program studimi. Në veçanti, në rregulloren mësimore të programit të studimit me karakter porofesional “Aplikime Informatike”, paraqiten kriteret e pranimit, përzgjedhjes, dhe avancimit të studentëve. Informacione që janë të qarta dhe të kuptueshme [7. Rregullore e programit të studimit DP Aplikime Informatike.pdf] [5. Rregullore e UET.pdf]
Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.	Institucioni, edhe në përmbushje të detyrimeve që vijnë si zbatim i akteve rregullatore në fuqi, harton dhe bën publike në ministrinë përgjegjëse për arsimin kriteret specifike. Këto kriteret bëhen publike edhe në faqen ueb të institucionit. Megjithatë, këtu mungojnë të dhëna të hollësishme rreth programit të studimit me karakter profesional “Aplikime Informatike”. Ky program studimi është në nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), dhe si e tillë nuk ka kriteret ligjore shtesë mesatare apo të ngjashme të përcaktuar në nivel kombëtar. Në këtë rast është vet institucioni që mund të vendosi kriteret shtesë përtej atij ligjor i përfundimit me sukses të shkollës së mesme apo në total 12 vite studim parauniversitar. [https://uet.edu.al/new/sq/si-te-aplikojme/] [27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.pdf]
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e	Institucioni ka në dispozicion zyrën për karrierën dhe udhëzimin e studentëve. Aty studentët mund të marrin të dhëna të hollësishme rreth programit të studimit, procedurat dhe kriteret specifike për përparimin e tyre akademik etj. Një pjesë e këtyre të dhënave janë publike edhe në faqen ueb të institucionit në përgjithësi. Në veçanti për këtë program studimi të dhënat në faqen ueb thuajse mungojnë. Në vaqen ueb të institucionit

afliësive të studentëve dhe diplomimit.	jepet vetëm kurrikula e programit të studimit. Megjithatë, pranë institucionit mund të merren të dhëna të detajuara për programin e studimit dhe veprimtaritë specifike të tij. [https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2019/01/DP-Aplikime-Informatike.pdf] [14. Kurrikula e programit – DP Aplikime Informatike.pdf] [32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.pdf]
Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni ka në organikë edhe zyrën e këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentëve. Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me autoritetet drejtuese dhe me zyrën e këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentëve pranohet që institucioni në mënyrë periodike kontakton studentët dhe i udhëzon ata jo vetëm drej mundësive të tregut të punës, por edhe në avancimet e tyre akademike. Komunikimi është periodik me email dhe në baëz të nevojave apo kërkesave, edhe me informacione në zyrat e institucionit. Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, u vu re, se nuk kishin patur informacione apo njoftime nga zyra e këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentëve. Nëse e kanë patur të nevojshme, studentët kanë marrë informacione nga koordinatori i programit të studimit. [Shënime në vizitë]
Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me studentët u pohua fakti se pedagogët të cilët zhvillojnë leksionet, në takimin e poarë me studentët, qartësojnë përmbajtjen e lëndës, detyrimet e saj, literaturën etj. Ky informacion gjendet edhe në syllabuset e lëndëve përkatëse, informacion që Ju bëhet i ditur studentëve nga pedagogët përkatës. Megjithatë, nuk ka të dhëna mjaftueshëm të publikuara të cilat të mund të aksesohen në mënyrë të pa varur nga studenti. Informacioni në faqen ueb të institucionit, për këtë program studimi është thujse inkesiztent.
Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Institucioni ka në përdorim një platformë elektronike të menaxhimit të aktivitetit didaktik (LMS: Learning Management System) dhe një platformë të menaxhimit të iuniversitetit UMIS. Bazuar në manualin e përdorimit për studentët dhe për pedagogun, sistemi LMS është lehtësisht i përdorshëm në dobi të aktivitetit didaktik. Sismi elektronik aksesohet nga cdo platformë kompjuterike në internet në faqen zyrtare të institucionit dhe me kredencialet zyrtare të studentëve në domain @uet.edu.al. [https://lms.uet.edu.al] [46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS.pdf] [46.2 UET LMS Guide per pedagogun.pdf]

	[46.3 UET LMS Guide per studentet.pdf]			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Bazuar në RVB, Universiteti Europian i Tiranës disponon dy sisteme të informatizuara të menaxhimit të brendshëm. UIMS dhe LMS. Ky i fundit është kryesisht në funksion të aktivitetit didaktik, ndërsa i pari në funksion administrativ të tij. Sistemi i menaxhimit i informatizuar është në ndihmë dhe në funksion të të gjithë informacionit që lidhet me studentët që nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. Gjithsesi, dokumentacioni zyrtar trajtohet sipas akteve ligjore/nën ligjore në fuqi nga zyra e sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore dhe të gjithë instancave përkatëse të cilat ruajnë kopje fizike/regjistra etj. Nga vizita në institucion, dhe në veçanti me sekretarinë mësimore vihet re përdorimi i sistemit informatik si nga pedagogët ashtu edhe nga sekretaria për informatizimin e të dhënave të studentëve. Përdorimi efikas i sistemit të menaxhimit lehtëson punën e sekretarisë pasi edhe vendndodhja e dokumenteve fizik në institucion është një e dhënë e këtij sistemi që ndihmon personelin për reflektimin e dokumenteve zyrtar edhe në dosjen e gjithsecilit student. [46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf] [46.2 UET LMS Guide per pedagogun.pdf] [Shenime në vizitë]
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i menaxhimit të brendshëm është një platformë informatike në përdorim nga institucioni, platformë që pasurohet herë pas here me module të reja sipas nevojave të vet institucionit. Sistemi i informatizuar është hierarkik dhe me privilegje në bazë të rolit që çdo personel akademik/administrativ apo në çfarëdo roli që ka në institucion, ka qasje në sistemin UMIS dhe LMS dhe të dhënat e ruajtura në të sipas funksionit fizik që mbulon. Kjo garanton edhe privatësinë e qasjes të dokumentacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi sikurse edhe lirinë akademike dhe të vlerësimit për të gjithë stafin. Një pjesë e veprimtarisë së menaxhimit të informacionit bazohet edhe në platformën Microsoft office 365 e cila lejon përdorimin e

	adresave të postës elektronike për të gjithë stafin dhe studentët nën domain @uet.edu.al. [46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf] [46.2 UET LMS Guide per pedagogun.pdf]
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi kryesor i menaxhimit LMS është një platformë informatike e bazuar në role dhe hierarki e cila përdoret në bazë përdorues/fjalëkalim. Të gjithë përdoruesit kanë qasje në të dhënat personale dhe mund të përditësojnë disa prej tyre si CV, foto etj. Qasja është me privilegje ku gjithsecili prej përdoruesve mund të aksesojë vetëm të dhëna në lidhje dhe të nevojshme për funksionin e tij brenda institucionit. [46.3 UET LMS Guide per studentet.pdf]
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi informatik i bazuar me privilegje dhe hierarki, lejon një formë komunikimi interaktiv midis studentëve dhe institucionit si dhe mes stafit dhe institucionit sikurse edhe mes stafit dhe studentëve. Për këtë qëllim përdoren edhe forumet apo chat-et e integruara në këtë sistem apo edhe në Microsoft Teams që është përdorur gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Studentët aksesojnë avancimin e tyre akademik, vlerësimet përkatëse, materialet e lëndëve të cilat përditësohen nga stafi akademik dhe aksesohen vetëm nga studentët përkatës në sistem të bazuar në platformën moodle.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raporte individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi i menaxhimit të brendshëm lejon krijimin e raporteve të personalizuar në lidhje me përdorimin e platformës. Për këtë qëllim, në mënyrë periodike, zyra e IT, harton raporte mbi përdorimin e platformës online dhe aktivitetin e cdo pedagogu. Akresi në këto raporte është i garantuar nga hierarkia dhe privilegjet e secilit përdorues. Një raport i përmbledhur mbi përdorimin e platformës online paraqitet edhe në dosjen e vlerësimit të këtij programi studimi. [46.5 Raport ecuria e mësimit online.pdf]
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen ueb të Universitetit Europian të Tiranës informacionet paraqiten në dy gjuhë, atë angleze dhe atë shqipe. Lundrimi në këtë faqe, lejon që të arrihen informacione në lidhje me të gjitha programet e studimit dhe aktivitetet e ofruara nga institucioni. Nga faqe ueb kryesore e institucionit mund të arrihen edhe faqe dytësore (domain sekondar) të cilat janë specifike për funksione të caktuara në institucionin si LMS etj. [https://uet.edu.al/] [https://lms.uet.edu.al]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm të hartuar nga vet institucioni si dhe në rregulloren e tij të publikuar në faqen ueb, institucioni ka një organizim të politikave dhe procedurave transparente që mbulojnë një cikël të plotë akademik nga hyrja e studentëve në vitin e parë akademik deri në përfundim të ciklit përkatës. Megjithatë, për programin e studimit me karakteri profesional "Aplikime informatike", nuk ka të dhëna të qarta në lidhje me njohjen e studimeve të mëparshme. Edhe në dokumentin e paraqitur në dosjen e vlerësimit, të dhënat janë të pëgjithëshme për programet e tjera të studimit të ofruara nga institucioni, por jo specifike për këtë program studimi. Megjithatë, duhet theksuar, se ky është një program studimi i përfshirë në nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), dhe si i tillë, institucioni zbaton vetëm kriterin minimal ligjor si kriter pranimi, pra atë të përfundimit me sukses të një arsimit 12 vjeçar parauniversitar. [28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf]
Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejtën e njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucionin, por edhe nga analiza e dokumantacionit të paraqitur për vlerësimin e këtij programi studimi, vihet re një trajtim uniform të të gjithë kandidatëve për student, i pavarur nga gjinia, bindjet politike apo fetare etj. Pra në opinionin tonë, institucioni garanton një barazi për të gjithë kandidatët për student por gjithashtu edhe për ata të regjistruar si student. E mbështetur kjo edhe në rregulloren e institucionit. [5.Rregullore e UET.pdf]
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Institucioni harton, miraton dhe publikon kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve. Këto i bën publike në sistemin U-Albania sipas udhëzimeve të MASR por edhe në faqen zyrtare të institucionit. Megjithatë për këtë program studimi nuk janë të parashikuara kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve. Për orientimin dhe informimin e kandidatëve për student, në mënyrë periodike institucioni organizon takime informuese, sqaruese dhe ndërgjegjësuës me gjimnazistë si në qytetin e Tiranës ashtu edhe në

	qytetet kryesore të Shqipërisë. Në kuadër të promovimit të institucionit dhe programeve të studimit të ofruara, hartohen edhe materiale informuese si fletëpalosje, postera, broshura etj.			
Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet: këshillimit me koordinatorin e programit të studimit. Në fillimi të çdo semestri akademik zhvillohet një javë orientuese me studentët në lidhje me lëndët që do të zhvillohen, kriteret dhe procedurat për të frekuentuar, përvetësuar dhe për tu vlerësuar në secilën lëndë apo cdo vështirësi/paqartësi që mund të kenë. [27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.pdf]			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.	Të gjitha të dhënat dhe kriteret e nevojshme për vlerësimin e dijeve janë të përcaktuara qartë në plan-programet e çdo lënde. Të dhëna të detajuara jepen edhe në sistemin e menaxhimit të brendshëm ku studentët kanë qasje të personalizuar në varësi të programit të studimit dhe lëndëve që duhet të ndjekin. Edhe në takimet informuese me koordinatorin e programit të studimit, studentët kanë mundësi të marrin informacione të hollësishme për të gjithë veprimtaritë akademike dhe vlerësuese të zbatuara nga institucioni. Të dhëna të përgjithshme jepen në rregulloren e programit të studimit, dhe në veçanti në syllabuset e secilës lëndë. [7. Rregullore e programit të studimit DP Aplikime Informatike.pdf] [syllabuset e lëndëve]			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Për orientimin dhe informimin e kandidatëve për student, në mënyrë periodike institucioni organizon takime informuese, sqaruese dhe ndërgjegjësuere me gjimnazistë si në qytetin e Tiranës ashtu edhe në qytetet kryesore të Shqipërisë. Në kuadër të promovimit të institucionit dhe programeve të studimit të ofruara, hartohen edhe materiale informuese si fletëpalosje, postera, broshura etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet: këshillimit me stafin akademik dhe administrativ si në momentin që

kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	interesohen apo pranohen në programin e studimit ashtu edhe gjatë karrierës së tyre studentore. Detaje specifike jepen edhe në plan-programet e lëndëve që u vihen në dispozicion studentëve si në platformën online ashtu edhe në formë e syllabuseve të lëndëve. [syllabuset e lëndëve]			
Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Institucioni ka në organikë Zyrën e Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve. Kjo zyrë ofron edhe shërbimin e këshillimit të studentëve për mundësitë e punësimit. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me studentët, u vu në dukje se studentët nuk kishin marrë informacione nga kjo strukturë e institucionit. Edhe pse nga takimi me përfaqësuesit e kësaj zyre u theksua që studentët kontaktohen në mënyrë periodike me email me informacione rreth mundësive të tregut të punës. Nga takimi me studentët u vu re se ata informacioni kryesor rreth praktikave dhe mundësive të punësimit i kanë marrë nga pedagogu tutor.			
Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	I gjithë informacioni lidhur me zhvillimin e procesit mësimor (orari mësimor, plani mësimor, silabuset e lëndëve, njoftime të ndryshme) u komunikohen studentëve nga koordinatori i programit të studimit ose/dhe nga sekretaria mësimore nëpërmjet publikimit në këndin e njoftimeve ose/dhe online në platformën LMS dhe nëpërmjet postës elektronike. [Shënime në vizitë]			
Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Institucioni UET ka në përdorim një sistem informatik të brendshëm LMS i cili aksesohet nga studentët dhe stafi në bazë të përdorues/fjalëkalim. Në këtë platformë studentët kanë të gjitha informacionet e nevojshme për programin e studimit, lëndëve përkatëse etj. Përdorimi i platformës Microsoft 365, dhe në rastin konkret të adresave të postës elektronike në domain @uet.edu.al lejon shpërndarjen e informacionit dhe aksesin e tij në distancë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e	Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. Këto të dhëna

studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	hidhen në Regjistrin e Diplomimeve së bashku me numrin e studentëve të regjistruar etj., deklarohen sipas kuadrit ligjor në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Të dhëna të përmbledhura jepen edhe në raportet vjetore (vit akademik) të hartuara nga institucioni Në këto raporte gjejmë tabela mbi vlerësimin mesatar të studentëve, kalueshmërinë në përqindje, diplomimin në kohë, punësimin etj. Numri i studentëve në këtë program studimi ka qenë në tre vitet e fundit si më poshtë <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Student të regjistruar në vit të parë</th><th>Nota mesatare</th></tr><tr><td>2018 – 2019</td><td>9</td><td>5.82</td></tr><tr><td>2019 – 2020</td><td>51</td><td>6.11</td></tr><tr><td>2020 – 2021</td><td>11</td><td>6.59</td></tr><tr><td></td><td>71</td><td></td></tr></table> [27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin.pdf]	Viti akademik	Student të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare	2018 – 2019	9	5.82	2019 – 2020	51	6.11	2020 – 2021	11	6.59		71	
Viti akademik	Student të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare														
2018 – 2019	9	5.82														
2019 – 2020	51	6.11														
2020 – 2021	11	6.59														
	71															
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti gjatë takimit sekretarinë mësimore, u paraqitën regjistrat me regjistrimet, ç’regjistrimet, transferimet e studentëve në këtë program studimi. Këto raporte jepen edhe të përmbledhura në raportet vjetore të cituara edhe më sipër. [27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin.pdf]															
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.	Të dhënat statistikore disponohen nga institucioni edhe në përmbushje të raporteve dhe udhëzimeve të kërkuara nga drejtori apo seksione të veçanta në Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve sikurse janë edhe raportet vjetore. Gjithashtu, përdorimi i platformës së menaxhimit elektronik të të dhënave lejon një qasje të menjëhershme në performancën akademike të studentit. Të dhënat përfshijnë të gjithë jetën e studenti në institucion, duke filluar që nga avancimi i tij akademik, të dhënat financiare në lidhje me institucionin, kërkesat e paraqitura për dokumentacione nga zyra të ndryshme brenda institucionit, etj.															
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti gjatë takimit me sekretarinë mësimore, u vu re përdorimi efektiv dhe efikas i sistemit të menaxhimit elektronik të brendshëm. Në këtë sistem ruhen të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me studentët që nga regjistrimi i tyre deri në përfundim të karrierës studentore. Këtu, dokumentacionin përveçse i azhurnuar në formatin elektronik, për efekte ligjore ruhet edhe në formë shkresore (hard copy). Ku forma shkresore është lehtësisht e arritshme në arkivën përkatëse me të dhënat e menaxhimit të ruajtura në sistemin informatik. [Shënime në vizitë]															

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar edhe në vizitën në institucion dhe në veçanti takimi me përfaqësues të zyrës së karrierës, vihet re se institucioni i kushton një rëndësi të veçantë mbledhjes së të dhënave të studentëve të diplomuar. Kjo shërben edhe si një tregues i cilësisë dhe përdoret për përmirësimin e vazhdueshëm për të ofruar një program studimit që formon profesionist në fushat përkatëse. Këto të dhëna jepen në formë statistikore edhe në raportet vjetore që hartohen nga institucioni. Edhe pse për këtë program studimi specifik nuk ka akoma të dhëna për studentët e diplomuar pasi është brezi i parë. [Shënime në vizitë]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Bazuar në statutin e institucionit, prania e përfaqësuesve të studentëve është e sanksionuar në të gjitha organet kolegjiale të tij. Në Universitetin Europian të Tiranës është i ngritur dhe funksionon edhe Këshilli Studentor i cili organizohet dhe kryen aktivitetin në bazë të statutit të tij dhe koordinon përfaqësimin e studentëve në të gjitha organet kolegjiale ku ata janë të përfshirë. Megjithatë, në këto organe, nuk ka përfaqësues të studentëve të këtij programi studimi edhe për faktin se pesha e këtij programi si numër studentësh kundrejt totalit të studentëve të regjistruar në këtë institucion, është e ulët.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Sipas statutit të UET, studentët janë të përfshirë në organet kolegjiale si: - Senati akademik; - Këshilli i etikës; - Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; Gjithashtu, institucioni, përmes, anketimeve, vlerësimeve periodike të studentëve për pedagogët, lëndët dhe institucionin, mbledh dhe përpunon të dhëna të cilat përdoren nga organet vendimmarrëse për menaxhimin e vet institucionit. Megjithatë, vlen të theksohet se anketimet e studentëve nuk janë detyruese për ta.[2.Statuti UET.pdf]
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të	Ngarkesa e programit të studimit është e shpërndarë në mënyrë uniforme gjatë dy semestrave për çdo vit akademik bazuar në planin

studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	mësimor përkatës me një ngarkesë rreth 20-25 orë javore në auditor. Plani mësimor është i organizuar konform VKM 41, datë 24.01.2018. Institucioni ka një rregullore mbi procedurat për transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin. [14.1. Plani mësimor i programit – DP Aplikime Informatike.pdf] [28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf]			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Institucioni, bazuar edhe në statutin e tij, garanton përfshirjen e përfaqësuesve të studentëve në organet kolegjiale vendimmarrëse. Megjithatë, strummenti kryesor i përdorur nga institucioni për të marrë mendimet dhe propozimet e studentëve, mbetet kryesisht anketimi. Studentët udhëzohen që periodikisht (dy herë në vit) të plotësojnë formular anketimi për vlerësimin e pedagogut. Plotësimi i këtij anketimi është jo detyrues për studentin. Gjithashtu, institucioni përdoru edhe grupet studentore për të marrë dhe analizuar mendimet e tyre për të cilat hartohen edhe raporte sipas formatit të paraqitur në dosjen e vlerësimit. [40. G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët.pdf] [2.1 Vlerësimi online i studentit për pedagogun dhe lëndën 2019-2020..pdf] [2.3 Format - Raport i fokus grupeve.pdf]			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët informohen që në momentin e regjistrimit në institucion mbi procedurat, rregulloret të drejtat dhe detyrimet e tyre. Edhe në rregulloren e programit të studimit paraqiten procedurat që i mundëson studentit të rishikojë dhe të qartësohet për vlerësimin e marrë për testimin e dijeve. Institucioni parashikon edhe formularë specifik për të trajtuar ankesat e mundëshme të studentëve dhe mënyrën se si ato duhet të trajtohen nga ana procedurale. Nga takimi me studentët në institucion u vu re një komunikim i hapur me stafin akademik dhe atë administrativ çka sillte një qartësim të problematikave dhe një zgjidhje të tyre në mënyrë natyrale dhe frytdhënëse për studentët dhe institucionin. [40.1. D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e	Institucioni, në organikën e tij ka Zyrën e Karrierës dhe Kujdesit

njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	ndaj Studentit, zyrë e cila në funksionin e saj ka pëlërisht informimin e studentëve. Përveç kësaj zyre, në funksion të informimit të studentëve është edhe koordinatori i programit të studimit si edhe tutori i studentit për praktikën profesionale. [dok 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj]			
Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në institucion është parashikuar dhe funksionon zyra e pranimeve, e cila ka në fokus informimin paraprak të të gjithë kandidatëve për student apo personave të tjerë të interesuar. Kjo zyrë ka edhe në ambientet e saj, broshura dhe fletëpalosje informuese në dispozicion të të interesuarve. Në bashkëpunim edhe me zyrën e Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, institucioni garanton mekanizmat e nevojshëm për informimin e studentit.			
Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me drejtuesit e fakulteteve dhe departamenteve. Në funksionin e kësaj zyre parashikohet informimi periodik i studentëve mbi mundësitë e bashkëpunimit apo karrierës jashtë institucionit, megjithatë vërehet një përdorim i ulët i këtij instrumenti me studentët e këtij programi studimi. [2.Statuti UET.pdf]; [dok 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj]			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.	Zyra e Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës përpilon të dhëna statistikore për studentët e diplomuar dhe punësimin e tyre mbas diplomimit. Institucioni ka edhe Shoqatën Alumni e cila mban kontakte të vazhdueshme me ish studentët e këtij institucioni. Të dhënat e mbledhura përfshijnë shkallën dhe llojin e punësimit të studentëve mbas përfundimit të studimeve. Për programin specifik nuk ka akoma student të diplomuar pasi është brezi i parë që arrin në përfundim të këtij programi studimi për këtë vit akademik. [dok 12. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Aplikime Informatike” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UET dhe të zhvillimit ekonomik të vendit dhe plotëson nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtare dhe lokale.
2. Staf akademik me përvojë në fushën e mesimdhënis dhe i motivuar në këtë proces.
3. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike e duhur në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor.
4. Kujdesi ndaj studentit realizohet në plotësim të të gjitha kushteve kontraktuale.
5. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi të reja në drejtim të bashkëpunimit akademik dhe profesional brenda dhe jashtë vendit.

Pika të dobta

1. Plani mësimor i këtij programi studimi paraqet mangësi në hartim, të gjitha lëndët bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore nuk kanë të parashikuara laboratorë. Mungesa e qartë e krediteve të parashikuara për punët laboratorike është një dobësi që lidhet me mundësinë e punësimit të studentëve në përfundim të tij.
2. Raporti i orëve/krediteve *pjesë teorike kundrejt pjesë praktike* në nivele të ulëta.
3. Orjentim i pamjftueshëm i studenteve ndaj zhvillimit të praktikave profesionale në kompani apo institucione jashtë IAL-së.
4. Mbulimi i ngarkesës akademike për këtë program studimi në masë më pak se 50% nga stafi akademik PAE+PAK i departamentit përgjegjës për këtë program studimi.
5. Programi i studimit ka mungesë në fondin e bibliotekës me literature në gjuhën shqipe.

Rekomandime:

1. Njësia bazë dhe ajo kryesore duhet të rregullojnë planin mësimor në mënyrë që sasia e orëve/krediteve të pjesës teorike dhe praktike të jetë konform ligjit dhe standarteve të cilësisë së arsimit të lartë.
2. Programet lëndore rekomandohen të azhurnohen sipas rekomandimeve të dhëna në këtë raport, të përmirësohen literaturat me botime më të reja për një pjesë të lëndëve. Në përgjithësi, të rishihen raportet si dhe të konsiderohen nevojat e studentëve për të përvetësuar më shumë pjesë praktike.
3. Njësia bazë duhet të ndërmarrë iniciativë të tjera në lidhje me aftësimin praktik të studentëve dhe përtej orëve në auditor. Lënda “Praktike dhe zhvillim student” të zhvillohet jashtë institucionit.

4. Mbulimi i ngarkesës akademike të garantohet kryesisht nga personel akademik i departamentit përgjegjës për programin e studimit.
5. Të pasurohet biblioteka me botime në gjuhën shqipe në funksion të këtij programi studimi.

Conclusions of the evaluation of the profesional study program, in “Application Informatics” of the European University of Tirana

Strengths and Affirmations:

1. The study program is designed in accordance with the development strategy of UET and the economic development of the Albanian country and meets the needs of the labor market, in accordance with the strategic goals of national and local economic development
2. Qualified and motivated academic staff;
3. Adequate facilities and appropriate didactic infrastructure available to the study program provides the necessary modern spaces and conditions for the learning process.
4. Student support is realized in fulfillment of all contractual conditions.
5. UET has signed new cooperation agreements in terms of academic and professional cooperation inside and outside the country.

Weaknesses:

1. The curriculum of this study program presents shortcomings in the design, all basic, characterization and interdisciplinary subjects do not have laboratories. The obvious lack of credits provided for laboratory work is a weakness related to the possibility of employing students upon its completion;
2. Low theory/practice ratio seen as ECTS credits and teaching hours.
3. Insufficient orientation of students towards the development of professional practices in companies or institutions outside the HEI
4. Low academic load for this study program (less than 50%) by the academic staff PAE + PAK of the department responsible for this study program.
5. The study program lacks the library fund with literature in Albanian language.

Reccomendations:

1. The departament responsible for this study program should adjust the theory/practice ratio seen as ECTS credits and teaching hours to be conform HEI quality standards.

2. Program syllabus are recommended to be updated according to the recommendations given in this report, to improve the literature with newer publications. In general, review the reports as well as consider the needs of students to acquire more practical teaching hours.
3. The responsible department should take initiatives related to the practical training of students and beyond the hours in the auditorium. The course "Internship and student development" to be covered outside the HEI.
4. Academic teaching load should be guaranteed mainly by the academic staff of the department responsible for the study program.
5. To enrich the library with Technical publications related to this study program in Albanian language.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

